

Statistikat tregtare Kosovë – Maqedoni e Veriut, 2015 -2024

Oda Ekonomike e Kosovës

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për periudhën janar-dhjetor 2024, deficitit tregtar ka shënuar një rënie prej 11.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, duke arritur në -153.7 milion euro nga -173.3 milion euro në 2023. Mbulueshmëria e importit nga eksporti ka arritur në 48.4%.

Analizuar në periudhën e fundit trevjeçare, paraqitet një trend i qëndrueshëm rritës i eksporteve me një mesatare vjetore prej 128.2 milion euro (+19.3%), ndërsa importet kanë shënuar një rritje mesatare prej 291.6 milion euro (+7.4%). Si rezultat, deficitit tregtar me Maqedoninë e Veriut ka regjistruar një rritje mesatare vjetore prej 163.3 milion euro, me një rritje të lehtë prej rreth 1%.

Maqedonia e Veriut, si shtet fqinj dhe anëtare e CEFTA, mbetet një partner i rëndësishëm tregtar për Kosovën. Gjatë vitit 2024, eksportet drejt Maqedonisë së Veriut arritën në 144.0 milion euro, duke përbërë 15.3% të eksporteve totale. Mesatarja vjetore e eksporteve për periudhën 2022-2024 është rreth 14.1%. Në anën tjetër, importet nga Maqedonia e Veriut në vitin 2024 shënuan 297.7 milion euro, ose 4.7% të importeve totale, ndërsa mesatarja vjetore për periudhën 2022-2024 qëndron rreth 5.0%.


Sipas të dhënave nga Open DATA - Doganat e Kosovës, grupet kryesore të eksportit për vitin 2024 përbëhen nga: 36.2% metale bazë dhe artikujt prej tyre, 14.8% produkte minerale, 13.7% ushqime të përgatitura, etj.

Ndërsa në import, grupet kryesore janë: 33.7% produkte minerale, 23.8% ushqime të përgatitura, pije dhe duhan, 8.8%, etj.


Përgatitur nga: Oda Ekonomike e Kosovës, Departamenti për Analiza dhe Komunikim Strategjik

Email: info@oek-kcc.org
Web: www.oek-kcc.org

Bilanci tregtar i mallrave me Maqedoninë e Veriut në mil. Euro



Eksportet 2024 sipas seksioneve-grup kapitujve, në %



Importet 2024 sipas Seksioneve-grup kapitujve, në %

